

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një spiune me moralin e Vlora Hysenit
ADRESA	https://www.cna.al/opinione/nje-spiune-me-moralin-e-vlora-hysenit-i475217
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 18:26:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 18:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dfaaf34bf7e7d68906eff4febfc6cd307ad5ee6b48878c77e23480eeb02cdbc0
TEKSTI	e873350b62756a5b67d3cb520affde1e6f27c846831867c36d06134aa1d9b9b1
PAMJA	1309c2f5bc9cc06d153db061dede4b3be0dd681c0c04fae10a96c8701e586e61

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fcdf3540dd21db0c63d2ff50fec8ee416d52530b22634cbcbfed37b52e93b27d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9fd2d6c8eaed582dbfbd973ad421bf483fa1abd0a548cdf1a11aa95128494a7b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fcdf3540dd21db0c63d2ff50fec8ee416d52530b22634cbcbfed37b52e93b27d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

20:11 Aktualitet

Brunilda Kadi është zgjedhur anëtare në Këshillin e Lartë ...

Një spiune me moralin e Vlora Hysenit



25 Shtator 2026, 20:15, Opinione Ilnisa Agolli



Kreu i komplotit, na kishte qenë tamam siç do e donte Fusheja. Një grua. Një grua që natyrisht nuk jam e sigurt në e nje Zhozef Fushenë, aq sa Z. Rama me të cilin në fakt, marrëdhënia mund të ishte pak më e bukur se ajo e Napoleonit me Fushenë. Që edhe në çaste tërbimi nuk e humbiste respektin për aftësitë e tij të jashtëzakonshe, megjithëse e dinte që ky njeri diabolik e mashtronte. Por Napoleon i ndehej mirë, sepse ky i fundit kuptonte. Ndërsa Vlorë, zhgënjeu po aq sa nuhatja politike e Z. Rama dhe në këtë rast marrëdhënia e tyre e shkurtrë.

Ish-drejtuesja e Sh.I.SH nga rrëmbimi, emocionet përvëluese të pushtetit dhe pasioni tulatur i detyrës, i lejoi vetes një kënaqësi totalisht të panevojshme që edhe mund ta kishte shmangur. Huqë kënaqësisë, të përplas fytyrës gjithmonë të vërteta të paretatshme. Vlorës, nuk ia kurseu emrin. Madje ia qëndisi dhe vari në kornizat e ligjit, prej ku do të mbahet mend si një gërmuese e zellshme informatash dhe thashethemesh.

Aq e shkujdesur ky gjah i majmë që u kap, sa dhe komplotistët po habiten se përse populli i gëzohet kaq shumë ekzekutimit të një njeriu? Vlorë, nuk parashikoi se fuqia populit kur fut hundët në jetën e punëve të errëta dhe fare larg parimeve revolucionare, është më e madhe se fuqia radarëve të famshëm, në mesazhet që i pamë të gjithë. Dedikim i guximshëm dashurie dhe në ashpërsinë e kësaj kohe të egër, jo gjithkush ka këtë fantazi. Andaj është e udhës, të flasë i gjithë qyteti për të.

Shqiptarët nuk e falin suksesin e tjetrit dhe ajo nuk mund të ishte e vetmja spiune dhe llafazane në këtë lojë, apo jo? Kështu më tha një fqinje në ashensor. E revoltuar madje shtoi, se me para blihet pushteti dhe me pushtet fitohen para. Nuk e di i thashë, nuk e njoh Ergys Agasin që të m'i çmonte shkathtësitë dhe pas intrigave të ndrya politike të më përdorte siç aparatet e posaçme. Megjithëse, kjo romanca e Vlorës me Agasin më kujtoi një libër që e kam të dashur. Manon Lesko, e cila mund të ishte një spiune perfekte nëse nuk do të binte në dashuri dhe pasioni i tepruar ta shtynte drejt krimeve të mëdha për një burrë, që të paktën i ofronte diçka.

Po çfarë ofronte Ergys Agasi që të gjithë i raportoheshin atij? Më kujtohet një episod, në podcastin "Flet" që zhvilloja në Top Channel dhe m'u ndalua emri tij të përmendej. Si puna e një dreke që është e ndaluar të flitet për politikë dhe qysh kur ndahet supa, një debat i marrë nuk vonon të ndezë gjakrat. Sidoqoftë, kjo histori që na ndezi atmosferën, i ka vënë flakën kureshtjes time se si do të zhvillohen ngjarjet, kur Z. Rama të kthehet në vend. Mesa duket kryeministri qenka mjaftuar vetëm ta vrojtonte Vlorën. Një tipar ky tipik i mjeshtrave historik politik, që rëndom ata të cilët i vendosin në krye të detyrave shtetërore, i përbuzin dhe nuk i marrin seriozisht; po aq sa zakoni vjetër i fjalimeve nga pala tjetër për përбетime dhe komplete, për tradhëtarë dhe intrigantë, përpara se të marrin postin dhe t'i nënshtrohen me devotshmëri shtetit, popullit dhe partisë.

E lodhshme!

Si mundet që vëmendjes së kryeministrit, që i nënshtrohet gjithçka t'i dalë jashtë radarëve një grua që sot është "Kreu i komplotit"? A do t'i vërsulet mbi të si mbi një pre tani që është i mirëinformuar, apo do të mundohet nga e para të fitojë besimin e shoqërisë përpara akuzës që i ra për hise të mbaj mbi shpatulla? Apo do ta shpëtoj prapë një tjetër mbështetës, dhe atë që dikur mbante për patriotë do ta ekzekutoj si mashtrues të ulët dhe të pështirë, duke parandaluar kështu të tjera krime dhe të tjera tradhëti.

Jemi të gjithë duke pritur fjalimin e tij, se si komplotistët një herë e përgjithmonë nuk do t'i shpëtojnë vigjilencës së popullit. Megjithatë, nuk duhet humbur kohë Z. Kryeministër i Shqipërisë, sepse të gjithë spiunët vijnë të sjellin të dhëna dhe të thurin në fshehtësi një tjetër goditje. Që vetëm historia do ta shkruajë mbi bazën e jashtme. Gjithsesi mua më pëlqen e gjitha kjo. Frymëzuese për të hedhur dritë mbi një roman si "Kreu i komplotit" që natyrisht mund ta shkruash ti dhe jo Ben Blushi.

Mua më ktheu tek libri i Fushesë dhe afërmendsh në këndin artistik më vjen si një dramë e madhe e gjitha kjo, ku aktorët në skenat e caktuara nga regjisori pritët të kenë vetëm një fund tragjik dhe ky i fundit si një zhbërillues i mirë, mendjen nuk e ka nga skena sa nga salla dhe lozhat. Të cilat nuk do të zbrazen kurrë, sa kohë që të kemi të njëjtët deputet që nuk harrojnë kurrë të blejnë dy bileta. Një për vete dhe tjetrën për përjetimin gjithë frikë, se mos ndoshta në përfshjen e radhës do t'i duhet të ngjiten në skenë.


Dhe për të hipur atje, nuk ka më nevojë për audicione.

Lista tashmë dihet.

Autorët i ndamë.

Vetëm diçka na e prish prapë.

Nuk dimë ku fiken radarët!





Të sugjeruara

Ish-shefja e SHISH nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj

VLORE MOJ NUR I PUSHTETIT

Skandal pas skandali/ Një palo shtet anëtar i NATO-s

Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!

TRADHËTIA NDAJ SHETIT

Kur kryeministri është edhe president dhe presidenti ndihmës i kryeministrit

Tani i Madh, Topi i Madh

Patriotët selektivë të patriotizmit selektiv

Disa sugjerime për konstatim të përbashkët të gjendjes pas Aktgjykimit të 16 shtatorit

Horizonti i Elbasanit

TË RROFTË EMRI...

Orët e Tiranës

Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!

Bojktoni takimet me politikanët e Shqipërisë që mbajnë peng demokracinë!

Kurbani i fundit për Kosovën/ Drejtësia e lupës politike dhe dora e historisë

Tirana pa kokë dhe medikamenti i kryeministrit

Dy fjalë të fundit për histerinë folklorike kundër ngritjes së Muzeut Hebraik në Vlorë

Ekspertët zbulojnë shtatë sjellje të çuditshme që mund të lidhen me inteligjencën e lartë

Dëgjimet komuniste të Ramës për Reformën Territoriale


Keqkuptimi me takimet e së premtes!

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

20:15 Opinione Ilnisa Agolli

Një spiune me moralin e Vlora Hysenit

13:10 Opinione Lorenc Vangjeli

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.